

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.


Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit nëntor, 2025

Këshilli i Ministrave miraton projektligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

26.11.2025: Miratohet nga Këshilli i Ministrave projektligji i ri “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Në mbledhjen e datës 26 nëntor 2025, Këshilli i Ministrave miratoi zyrtarisht projektligjin, i cili tashmë i është përcjellë Kuvendit të Shqipërisë për ndjekjen e procedurave parlamentare. Ky projektligj është një prej nismave të para të paketës ligjore “Antikorrupsioni” dhe synon të garantojë një sistem të fortë, të sigurt dhe funksional për raportimin e shkeljeve dhe rasteve të dyshuara për korrupsion në sektorin publik dhe atë privat, duke mbrojtur sinjalizuesit nga çdo formë hakmarrjeje. Nisma ligjore konsolidon punën e përbashkët të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në cilësinë e ministrit ligj-propozues, Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe ILDKPKI, si autoritet përgjegjës për zbatimin e ligjit. Miratimi i projektligjit në Këshillin e Ministrave vjen pas një procesi të gjerë konsultimi publik dhe pune teknike ndërinstitutionale, që siguroi përputhshmërinë e tij me standardet më të mira evropiane dhe specifikisht linjëzimin e Direktivës së BE për sinjalizimin si pjesë e kuadrit të brendshëm ligjor antikorrupsion. Ky hap forcon më tej angazhimin e qeverisë për të krijuar një mekanizëm efektiv dhe të besueshëm raportimi, në mbështetje të administratës publike dhe qytetarëve.

Projektligji i miratuar nga Këshilli i Ministrave mund të aksesohet në link:
<https://www.kryeministria.al/newsroom/projektligje-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-26-nentor-2025/>




Projektligji “Për lobimin” një akti i ri rregullator i paketës “Antikorrupsioni”

26.11.2025: Hartimi i projektligjit “Për lobimin” ka hyrë tashmë muaj në një fazë të re dhe të rëndësishme. Pas publikimit të nismës në regjistrin e konsultimit publik dhe mbledhjes së komenteve, u organizua një tryezë e posaçme konsultimi, ku u diskutuan propozimet dhe vërejtjet e ngritura nga institucionet publike, komuniteti i biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës. Tryeza shënoi përmbylljen e procesit të konsultimit publik dhe hapi rrugën për finalizimin e tekstit të projektligjit, i cili synon të sjellë një kuadër bashkëkohor, transparent dhe të standardizuar për rregullimin e veprimtarisë së lobimit në Shqipëri. Projektligji do të garantojë formalizimin e kontakteve mes lobistëve dhe vendimmarrësve, krijimin e një Regjistri Publik të Lobimit, forcimin e mekanizmave të deklarimit dhe raportimit, si dhe rritjen e llogaridhënies në proceset e politikëbërjes dhe administrimit publik. Përmbyllja e kësaj faze konsolidon një tjetër nismë të paketës ligjore “Antikorrupsioni”, duke e afruar më tej Shqipërinë me standardet e Rekomandimit CM/Rec(2017)2 të Këshillit të Evropës dhe praktikrat më të mira të vendeve të BE-së në fushën e transparencës së lobimit. Projektligji “Për lobimin” pritet të miratohet së shpejti në Këshillin e Ministrave.

Nëntor 2025; Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit propozon 5 masa disiplinore për zyrtarë publikë

1-30.11.2025: Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e hetimit dhe verifikimit administrativ vijon me verifikimin e rasteve (ankesa/denoncime) të përcjella nga qytetarët dhe të administruara nga Drejtoria e Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ dhe Koordinatorët kundër Korrupsionit. Gjatë muajit nëntor 2025, janë konkluduar 2 raporte përfundimtare për Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës mbi bazën e analizës së plotë të fakteve dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, dhe propozuar 5 masa disiplinore për titullarë, ish-titullarë dhe punonjës të institucioneve ku është kryer hetimi. Gjithashtu, nisur nga roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit për sa i përket parandalimit të korrupsionit, është vijuar me propozimin e rekomandimeve, të cilat bazohen në parimet e përmirësimit të qëndrueshëm të institucionit, kapaciteteve menaxhuese, ligjore, dhe teknike në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Nëpërmjet rekomandimeve synohet ndikimi konkret në përmirësimin e problematikave sistematike, të cilat lidhen me qartësimin e praktikave të brendshme, standardizimit të procedurave në lidhje me aspektet administrative dhe organizative, forcimit të bashkëpunimit ndërinstitutional, si dhe rritjes së llogaridhënies. Në këtë kontekst, nëpërmjet 2 raporteve të këtij muaji janë propozuar 4 rekomandime të cilat në 2 raste adresojnë çështje të natyrës administrative dhe lidhen me procedura konkrete dhe në 2 raste adresojnë çështje me natyrë organizative si në lidhje me menaxhimin e përditshëm dhe procedurat e brendshme të institucionit.



Shqipëri – EBA, shkëmbim eksperiencash në fushën dhe kompetencat ekzekutive antikorrupsion

14.11.2025: Vendosen urat e bashkëpunimit të autoriteteve përgjegjëse të Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, në fushën e antikorrupsionit. Përfaqësues të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit pritën në Tiranë një delegacion të Autoritetit të Llogaridhënies së Emirateve të Bashkuara Arabe, në kuadër të shkëmbimit institucional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e integritetit dhe qeverisjes së mirë. Diskutimet u fokusuan në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira mbi ndërtimin e sistemeve të forta të integritetit, forcimin e transparencës dhe nxitjen e përgjegjshmërisë në administratën publike. Gjatë takimit, përfaqësues të Shqipërisë prezantuan kuadrin kombëtar antikorrupsion, përfshirë qasjen ndërsektoriale të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, mekanizmat e monitorimit të zbatimit, si dhe rolin e Planeve të Integritetit si instrumente orientues në identifikimin dhe parandalimin e risqeve të korrupsionit. Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt vendosjes së kanaleve të qëndrueshme të komunikimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitutional mes këtyre dy autoriteteve, me synim promovimin e standardeve të larta të integritetit dhe rritjen e llogaridhënies publike.

Bashkëpunim ndërkombëtar; Shqipëria merr pjesë në punimet plenare të IACA

10.11.2025: Drejtori i Përgjithshëm i Antikorrupsionit, z. Insidor Rexhepi, mori pjesë në punimet e Sesionit të Katërmbëdhjetë të Asamblesë së Palëve të Akademisë Ndërkombëtare Antikorrupsion IACA, një prej forumeve globale më të rëndësishme të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të praktikave në fushën e integritetit dhe qeverisjes së mirë. Punimet e Asamblesë rikonfirmuan rolin kritik të edukimit, trajnimit profesional dhe kërkimit shkencor në forcimin e mekanizmave antikorrupsion dhe në mbështetjen e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, me fokus të veçantë tek ndërtimi i institucioneve të forta, të ndershme dhe efektive. Pjesëmarrja e Shqipërisë në forume të tilla ndërkombëtare nënvizon angazhimin e saj për të avancuar me standardet më të mira të integritetit, bashkëpunimin global dhe për të kontribuar aktivisht në përpjekjet ndërkombëtare kundër korrupsionit. Punimet plenare i paraprijnë konferencës së dytë globale antikorrupsion, që pritet të organizohet në selinë e OKB, në New York, SHBA, ku Shqipëria do të jetë prezente me delegacion shtetërore.





Gjashtë orë të hapura informative për integritetin në gjimnazet e Tiranës

19-26.11.2025: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit zhvilloi përgjatë muajit nëntor një cikël prej gjashtë orësh të hapura me nxënësit e klasave të 10-ta në disa shkolla të mesme të Tiranës, me fokus ndërtimin e kulturës së integritetit, etikës dhe qytetarisë së përgjegjshme tek të rinjtë.

Takimi i parë (19.11.2025) u zhvillua në gjimnazin “Asim Vokshi”, ku u diskutua mbi rëndësinë e etikës, sjelljes së përgjegjshme dhe kulturës së ligjit në jetën e përditshme. Nxënësit reflektuan mbi sfida të përditshme dhe mënyrat se si vendimarrja etike kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe transparente.



Më 20.11.2025, ora e hapur vijoi në gjimnazin “Ismail Qemali”, me fokus tek vlerat themelore të ndershmërisë, respektimi i rregullave, reagimi ndaj padrejtësive dhe roli i të rinjve në parandalimin e korrupsionit. Diskutimet u shoqëruan me shembuj nga përvoja e vetë nxënësve.



Takimi i tretë (21.11.2025) u mbajt në gjimnazin “Qemal Stafa”, ku u trajtuan dilema etike nga jeta e përditshme, rëndësia e reagimit ndaj sjelljeve të papërshtatshme dhe nevoja që të rinjtë të marrin rol aktiv në promovimin e integritetit institucional

Më datë 25.11.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ishte në auditorin e gjimnazit “Petro Nini Luarasi” ku etika, integriteti dhe njohuritë për ligjin dhe masat e dënimit patën interes të shtuar dhe shtuan njohuritë e nxënësve.



Më datë 26.11.202, përmbyllëm ciklin e orëve të hapura me sesione të zhvilluara në dy shkollat e: “Eqerem Çabej” dhe “Myslym Keta”. Gjatë këtyre takimeve u theksua rëndësia e marrjes së vendimeve të nderhme, forcimit të kulturës së përgjegjshmërisë dhe kontributit të secilit nxënës në promovimin e transparencës dhe etikës në komunitetin shkollor dhe më gjerë.



Përmes diskutimeve, rasteve praktike dhe bashkëbisedimit të hapur, nxënësit u angazhuan aktivisht, shtruan pyetje dhe sollën reflektime mbi situata konkrete të jetës shkollore dhe shoqërore, duke treguar interes të lartë për tematikat e integritetit dhe luftës kundër korrupsionit. Aktivitetet e nëntorit konfirmojnë rëndësinë e investimit të të rinjtë si aktorë të rëndësishëm në forcimin e kulturës së ligjshmërisë dhe integritetit publik. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit falënderon drejtuesit e shkollave, mësuesit dhe veçanërisht nxënësit për mikpritjen, angazhimin dhe bashkëpunimin e treguar. Orët e hapura mbi luftën kundër korrupsionit mbështetur tek integriteti i hapin udhën aktivizimit të nxënësve në fushatën vjetore të Java e Integritetit, 2025.

Forcimi i rolit të të rinjve romë në luftën kundër korrupsionit

25 & 27.11.2025: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit mori pjesë në Konferencën me temë: “Të rinjtë romë – Ambasadorë për një shoqëri pa korrupsion”, organizuar nga IRCA (Institute of Romani Culture in Albania), pranë auditorëve të Universitetit Mesdhetar në Tiranë dhe Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan. Konferenca mbledhi përfaqësues të institucioneve qendrore dhe atyre lokale me rol parandalimin e korrupsionit, përfaqësues nga shoqëria civile dhe stafi akademik me qëllim diskutimin e tematikave që lidhen me praktikën më të mira në edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve mbi rolin që kanë në parandalimin e korrupsionit. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit iu bashkua panelit mbi rolin e institucioneve qendrore dhe vendore në parandalimin e korrupsionit duke prezantuar rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitutional, zhvillimet kryesore lidhur me Strategjinë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit dhe Planin e saj të Veprimit, si dhe aktivitetet kryesore që burojnë nga Plani i Veprimit të cilat lidhen me edukimin e të rinjve, kurrikulat mësimore dhe aktivitetet ndërgjegjësuere në shkolla.

